



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

**I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË
KOSOVËS, E MBAJTUR MË 18 DHJETOR 2014**

**SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA,
ODRŽANE 18. DECEMBRA 2014. GODINE**

**DHJETOR - DECEMBAR
2014**

Rendi i ditës

1. Miratimi i propozim-vendimit për formimin e komisioneve parlamentare.

Dnevni red

1. Usvajanje predlog-odluke o formiranju parlamentarnih komisija.

Mbledhjen e drejtoi kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli.

KRYETARI: Të nderuar deputetë,
I nderuar kryeministër,
Të nderuar zëvendëskryeministra dhe ministra të Kabinetit qeveritar,
I hap punimet e seancës plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës,
Konstatoj se në sallë janë të pranishëm 108 deputetë, andaj fillojmë me punimet e seancës plenare.

Deputetë të nderuar,
Para se të fillojmë me rendin e ditës, ju njoftojmë me zëvendësimet e deputetëve të cilët janë zgjedhur anëtarë të Kabinetit qeveritar.

Me kërkesë të kryetarit të Kuvendit, e me vendim të presidentes së Republikës së Kosovës, është bërë zëvendësimi i deputetëve në Kuvendin e Republikës së Kosovës, si në vijim:

Zoti Nait Hasani e zëvendëson zotin Hashim Thaçin,
Zoti Shaip Muja e zëvendëson zotin Hajredin Kuçin,
Zoti Fadil Demaku e zëvendëson zotin Arsim Bajramin,
Zoti Hajdar Beqa e zëvendëson zotin Memli Krasniqin,
Zonja Salihe Mustafa e zëvendëson zonjën Edita Tahirin,
Zoti Murat Hoxha e zëvendëson zotin Isa Mustafën,
Zoti Agim Kikaj e zëvendëson zotin Kujtim Shalën,
Zoti Bardhyl Meta e zëvendëson zotin Haki Demollin,
Zoti Milazim Haliti e zëvendëson zotin Abdullah Hotin.
Zonja Synavere Rysha e zëvendëson zonjën Hykmete Bajramin,
Zoti Fikrim Damka e zëvendëson zotin Mahir Yagcilarin,
Zoti Qerim Bajramin e zëvendëson zoti Rasim Demirin dhe
Zoti Faton Topalli e zëvendëson zotin Dardan Sejdiun.

Deputetët e rinj i njoftoj se betimi i deputetëve është një veprim i paraparë me Kushtetutën dhe me Rregulloren e Kuvendit.

Tekstin e deklaratës së betimit e ka secili deputet para vetes dhe i njëjti duhet të nënshkruhet personalisht. Në të njëjtën kohë, ju kisha lutur pasi që ta nënshkruani t'i dorëzoni edhe administratës për arsye se pa këtë nënshkrim deputetët nuk mund të procedojmë më.

Pra, edhe atë pjesë procedurale e përfundojmë. Për të përmbushur këtë detyrim lus deputetët që të ngritën në këmbë, të dëgjojnë tekstin që do ta lexoj unë dhe vetëm në fund të gjithë së bashku shqiptojmë fjalën: “betohem” dhe atë secili në gjuhën e vet. Lus deputetët që të ngrihen në këmbë.

“Unë, deputet i Kuvendit të Republikës së Kosovës, betohem se me nder e me përkushtim do ta kryej detyrën time dhe do ta përfaqësoj me dinjitet popullin, do të punoj në interes

të Kosovës dhe të gjithë qytetarëve të saj, do të angazhohem për mbrojtjen dhe për respektimin e kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë, për mbrojtjen e tërësisë territoriale dhe të integritetit institucional të Kosovës, për garantimin e lirive dhe të drejtave të njeriut, në përputhje me ligjet e vendit dhe me standardet evropiane”. Betohem! Urime!

(Duartrokitje)

Të pranishëm në sallë janë 110 deputetë aktualisht, pas betimit.

Gjithashtu ju njoftoj se deputetja Emilija Rexhepi, nga data 18 dhjetor 2014, i është bashkuar Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës.

Në vazhdim procedojmë me rendin e ditës, të përgatitur nga Kryesia e Kuvendit në marrëveshje me grupet parlamentare.

1. Miratimi i propozim-vendimit për formimin e komisioneve parlamentare

Kryesia e Kuvendit të Republikës së Kosovës, në bazë të nenit 15, paragrafi 1 të Rregullores së Kuvendit dhe në marrëveshje me grupet parlamentare në mbledhjen e mbajtur më 17 dhjetor 2014, ka vendosur që në seancën e sotme plenare të procedohet me propozimin për formimin e komisioneve parlamentare në dy variante të mundshme.

Varianti i parë: Propozim vendimi për formimin e 14 komisioneve parlamentare i cili kërkon miratimin me 2/3 e votave të deputetëve të Kuvendit. Gjithmonë po vazhdojmë me propozimin e parë me shpresën se do të kalojë me të parën.

Grupet parlamentare në bazë të përfundimit të Kryesisë së Kuvendit të 11 dhjetorit 2014, i kanë propozuar emrat e deputetëve për kryetar, zëvendëskryetar dhe anëtarë për 14 komisione parlamentare.

Propozim-vendimi për formimin e 14 komisioneve parlamentare u është shpërndarë deputetëve të Kuvendit.

Në ndërkohë Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës dhe Grupi Parlamentar i Lëvizjes “Vetëvendosje” i kanë propozuar disa ndryshime në komisione.

E ftoj kryetarin e Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës, zotin Adem Grabovci që t’i paraqesë ndryshimet të paraqitura pas shpërndarjes së propozim - vendimit.

ADEM GRABOVCI: Faleminderit, kryetar!

Ne i kemi dorëzuar me shkrim në Administratë, besoj që nuk ka nevojë t’u marrë kohën e çmueshme, kolegëve të nderuar.

Ne i përmbahemi dhe përkrahim vendimin ashtu siç jemi marrë vesh në mbledhjen e fundit të Kryesisë, së bashku me shefat e grupeve parlamentare që kjo legjislaturë t'i ketë gjithsejtë 14 komisione. Faleminderit!

KRYETARI: E ftoj kryetarin e Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”, deputetin Visar Ymeri që t'i paraqesë ndryshimet të paraqitura pas shpërndarjes së propozim-vendimit.

VISAR YMERI: Deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës,
Ne i kemi bërë disa ndryshime në emrat e anëtarëve në komisionet parlamentare, të cilin e kemi dorëzuar po ashtu me shkrim dhe e kemi protokolluar, por për hir të procesverbalit po i lexoj këtu sepse nuk janë shumë.

Te Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike, shkon deputeti Besnik Bislimi, në pozitën e kryetarit, në vend timin, dhe po ashtu ndryshimi është te Komisioni për Buxhet dhe Financa, ku unë do të jem anëtar, në vend të Besnik Bislimit, si dhe te Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, ku po ashtu unë do të jem në pozitën e nënkryetarit.

Meqenëse jam këtu, po e shfrytëzoj rastin edhe për ta deklaruar qëndrimin e Lëvizjes “Vetëvendosje” karshi këtij propozimi për komisione. Ne mbesim në qëndrimin e njëjtë që kemi pasur edhe herën e kaluar. Ne nuk e kundërshtojmë numrin 14 të komisioneve, mendojmë që ky Kuvend duhet të ketë më shumë komisione në mënyrë që ta ketë mundësinë më të madhe për ta mbikëqyrë dhe kontrolluar punën e ekzekutivit, mirëpo kemi qenë dhe vazhdojmë të mbesim të pakënaqur me çelësin i cili është përdorur për ndarjen e komisioneve si dhe me numrin e anëtarëve në këto komisione dhe rrjedhimisht do ta votojmë kundër këtij propozim. Faleminderit!

KRYETARI: Zoti Ismet Beqiri, ju kisha lutur gradualisht për arsye se jam duke proceduar në bazë të një skenari. Kërkoj falje!

ISMET BEQIRI: Faleminderit! Unë besoj që, me qenë se po bëhet deklarimi duhet të na jepni sipas radhës të grupeve parlamentare fjalën, sepse është seancë e re dhe unë e them atë që jemi marrë vesh në Kryesi, është që ne jemi për 14 komisione dhe si të tillë grupi ynë parlamentar do të votojë këtë numër të komisioneve. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Paraprakisht kisha kërkuar mirëkuptimin e gjithë juve. Jemi në fazën ende të sqarimit të procedurave, për arsye se ende as nuk kemi pasur hapje diskutimit në kuptimin, për arsye se është seancë e re grupet parlamentare kanë mundësi për t'u deklaruar për variacionin e parë, po në të njëjtën kohë edhe pse janë shteruar diskutimet mund edhe të ketë diskutime. Por, ajo çfarë dua paraprakisht para se të shkojmë më tej të sqaroj një pozicion i cili është te propozimet e dy variacioneve. Për arsye se unë mbet borbh variacionin e dytë me qëllim nuk e diskutova për 13 komisione.

Ka qenë një qëndrim i përbashkët, unanim i Kryesisë dhe i shefave të grupeve parlamentare që sot para jush të vijmë me dy propozime. Propozimi i parë do të jetë për

14 komisione, por duhet ta kemi parasysh se i njëjti propozim, pa asnjë ndryshim ka qenë edhe herën e kaluar edhe nuk është aprovuar. Në të njëjtën kohë është edhe propozimi i dytë i cili është për 13 komisione parlamentare, i cili po ashtu do të procedohet sot, jo unë kisha pasur dëshirë të kemi sukses, sido që të jetë do të mbetemi pra te diskutim-propozimi, përkatësisht për 14 komisione parlamentare. Në qoftë se ka ndonjë deklaram nga grupet parlamentare, shefat e grupeve parlamentare, i lus kush dëshiron të deklarohej? Atëherë, u shterua debati. Edhe një herë, a u shter debati?

Më falni, prapë nuk kemi mirëkuptim për arsye se, vetëm pak ju lutem, është seancë e re. Debati do të vazhdojë edhe kush dëshiron të diskutojë, do të diskutojë, ta kemi parasysh, kjo është seancë e re. Unë i bindem Rregullores së Kuvendit, kush dëshiron të diskutojë, ka të drejtën të diskutojë, le te urdhërojë. Shefat e grupeve parlamentare, atëherë kryetari i Grupit Parlamentar të PDK-së, e do fjalën?

(Reagim nga salla)

Edhe i LDK-së, i “Vetëvendosjes” ju lutem! Nuk ka. Nga AAK-ja e ka fjalën Donika Kadaj-Bujupi.

DONIKA KADAJ-BUJUPI: Faleminderit!

Të nderuar kolegë deputetë,

Derisa në Qeveri po vazhdon akomodimi i klienteles partiake, duke emëruar deri në 70 zëvendësministra, ne nuk e shohim të arsyeshme për ta zvogëluar numrin e komisioneve përkundrazi jemi për 14 komisione të cilat do të mbikëqyrin Qeverinë, mirëpo do të votojmë kundër këtij propozimi për shkak të metodologjisë së ndarjes së komisioneve, siç kemi thënë edhe në të kaluarën.

KRYETARI: Nga Grupi Parlamentar “Nisma”, a ka dikush për të diskutuar? Nuk ka. Lista serbe, ju lutem!

SAŠA MILOSAVLJEVIĆ: Hvala predsedniče!

Uvaženi članovi Vlade,

Premijeru,

Dragi kolege,

Ja i kolegince smo i na samom Predsedništvu rekli da građani Kosova ne smeju da čekaju na početak rada ove institucije, čekaju previše. Mi smatramo da svi danas treba da se uzdignemo iznad ličnih i partijskih interesa, i danas ne glasamo samo za broj komisija nego glasamo za početak rada ove institucije i tad kada budete glasali, treba prvo to da bude na pameti, i zamolimo još jednom da se svi uzdignemo iznad ličnih i partijskih interesa i danas glasamo za početak rada ove institucije. Hvala!

KRYETARI: Nga Grupi Parlamentar “6+”, fjalën e ka Myfera Shiniq.

Öncelikle Meclis Başkanlık toplantısında “6+” Parlamenter Grubu on dert komisyon teklifibi kabul edeceğini bildirdik. Ben tekrardan burda meevkidaşlarımdan altı ay

bekleyen Kosova toplumunun çalışma ihtiyacımızın olduğunu bildiğimizden dolayı bugün burda bu komisyonların oylanmasını bekliyoruz.

Teşekkür ederim!

KRYETARI: Fjalën e ka Alma Lama.

ALMA LAMA: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar deputetë,

Në mandatin e kaluar unë e kam ngritur disa herë një çështje me shumë rëndësi që ka të bëjë me pjesëmarrjen e të gjithë deputetëve ose me barabarësinë e deputeteve në komisione. Faktikisht Rregullorja është e padrejtë, sepse disa deputetë, sidomos të grupeve të vogla parlamentare marrin pjesë në 2- 3 komisione me të drejtë vote, ndërkohë që ka deputetë të tjerë, të cilët nuk marrin pjesë në asnjë komision.

Mendoj se duke qenë se jeni duke diskutuar për këtë çështje duhet të rregullohet njëherë e mirë. Të gjithë deputetët janë të barabartë. Ata vijnë nga vota dhe kanë legjitimitet demokratik dhe përderisa vota është e barabartë këtu në Kuvend, mendoj që vota duhet të jetë e barabartë edhe në komisione.

Rregullorja mundëson që deputetët të marrin pjesë në të gjitha komisionet, ku dëshirojnë, mirëpo të kenë të drejtën e votës vetëm në një, për grupet e vogla në disa. Mendoj që grupet e vogla kanë të drejtë të përfaqësohen, por jo me të drejtën e votës së dyfishtë, të trefishtë apo dhe të katërfishtë, që kemi pasur në mandatin e kaluar. Prandaj, ju ftoj ta shihni me kujdes këtë çështje dhe të rregullohet. Faleminderit!

KRYETARI: Deputeti Daut Haradinaj e ka fjalën. Ndërkohë, derisa të vijë deputeti, vetëm ta sqaroj, kjo është çështje në dorën tuaj. Rregullorja ndërrohet në çdo kohë me 2/3-at e votave.

DAUT HARADINAJ: Po të them kryetar, pasi që të kanë votuar edhe LDK-ja dhe unë s'kam arsye më shumë për të mos thirrur, kryetar. Mendoj që tash i keni pru deputetët e ri dhe i keni numrat, mund ta hidhni në votim edhe t'i zgjidhni komisionet, por ajo që është e vërtetë edhe njëherë po them, në rast se rriten dy komisione, nuk mendoj që dëmtohet procesi i legjislativit në këto katër vjetët e ardhshëm.

Te seleksionimi i deputetëve të minoriteteve, të komuniteteve ose si të doni quajeni ju, unë mendoj që këto probleme duhet t'i zgjidhni brenda Kryesisë, atje, t'i depozitoni kërkesat e juaja e jo të vini këtu e të na tregoni se kush do të ishte më mirë të jetë e kush jo. Ato janë të zgjidhura.

Edhe njëherë po them, mos ta debatojmë gjatë, po hidhni në votim. Por, në rast se i rritni dy komisione, nuk dëmtoni të ardhmen katërvjeçare të këtij legjislativi. Aq më tepër, po flas meqenëse jam propozuar prej grupit për Komision të Sigurisë. E do të ishte më mirë edhe për ta ndarë Ushtrinë dhe Policinë, duke pasur parasysh se Ushtria në këtë mandat do ta marrë formatin, legjitimitetin e këtij Parlamenti për themelimin e Ushtrisë dhe ishte

dashur të jetë një komision i veçantë, zoti kryeministër, për shkak se është e domosdoshme një mbikëqyrje, një gatishmëri, një vullnet i deputetëve për t'i dhënë mbështetje nga legjislativi për themelimin e këtij institucioni jashtëzakonisht të rëndësishëm.

Tek punët e brendshme - Ministria e Punëve të Brendshme ju e dini që brenda kësaj ministrie ka shumë komponentë të cilët iu kanë bashkuar, nga emergjencat, pasaportat, Agjencia Civile, domethënë ka shumë segmente i cili është brenda Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe një komision është shumë e pamundur, kushdo që të jenë ata, të ushtrojnë funksionin e vet në kuadër të këtij mandati që vjen.

Dijeni edhe këtë, unë po u them edhe njëherë, mos u ngushtoni, se nuk është shumë me rëndësi se sa komisione do të rriten, për shkak se kostoja buxhetore nuk i kushton shumë Parlamentit të Kosovës, është një kosto jashtëzakonisht e vogël, por funksionimi i këtij komisioni do të ishte shumë e rëndësishme në rast se do të ndahej Ministria e Punëve të Brendshme dhe e Mbrojtjes për të qenë shumë më e gatshme për ta avancuar procesin, për të cilin ne thirremi për çdo ditë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Megjithatë, më duhet të ritheksoj prapë, çështja e komisioneve parlamentare nuk është çështje e cila përcaktohet njëherë e përgjithmonë. Votimi i fundit i cili ka ndodhur në Parlamentin e kaluar ka qenë, janë zvogëluar nga 16 komisione, me aq sa di unë, në 13 komisione. Dhe, kjo varet gjithmonë nga ju, me 2/3-at e votave çdo ndryshim nga 13 komisione parlamentare duhet të votohet me 2/3-at e votave.

Edhe njëherë edhe ky propozim që është aktualisht propozimi i parë, me 14 komisione parlamentare i duhen 2/3-at e votave. Kjo ka qenë edhe një arsye pse ne kemi mundur të procedojmë edhe me 13 komisione parlamentare edhe ta kalojmë këtë pjesë të komisioneve parlamentare. Të njëjtën kohë, në çdo moment, që nga dita e nesërme në bazë të Rregullores së Kuvendit, nenit 15, pika 2, mund që nga nesër të propozohen edhe komisione tjera parlamentare, pastaj ju vendosi se si dëshironi të votoni, po apo jo.

A ka edhe dikush diskutime? Po, ju lutem! Zoti Nuredin Ibishi e ka fjalën.

NUREDIN IBISHI: Të nderuar të pranishëm,

Unë desha vetëm t'jua tërheq vëmendjen lidhur me mbarëvajtjen e votimit, pasi që po hyn në atë fazën përfundimtare, herën e kaluar nëse nuk gaboj, kemi pasur të pranishëm 98. Kur u bë votimi, në momentin e votimit 58 ishin për, ishin 32 kundër, s'pati abstenime dhe në fund dolën se janë gjithsej 90. Unë s'di ku mbetën edhe 80 të tjerë. Pra, vetëm për atë e kisha. Faleminderit!

KRYETARI: Ju lutem, a ka dikush ende për diskutim? E ka fjalën deputetja Sala Shala.

SALA SHALA: Faleminderit, kryetar i Kuvendit!

Së pari më lejoni, që të nderuar kolegë deputetë dhe deputete të Parlamentit të Republikës së Kosovës, t'ju uroj të gjithëve mandatin e ri në këtë legjislaturë dhe dëshiroj që të gjithë

bashkërisht të punojmë me përkushtim dhe të punojmë me një sinqeritet për të mirën e qytetarëve të Kosovës, pa dallim ngjyrimi politik.

Më lejoni që ta uroj edhe kryetarin e Parlamentit të Kosovës, zotin Kadri Veseli, për detyrën që ka marrë dhe i dëshiroj shumë sukses.

Po shfrytëzoj rastin që në këtë foltore, meqë jam për herë të parë duke diskutuar në këtë legjislaturë, t'i përshëndes dhe t'i falënderoj të gjithë votuesit e mi, të cilët ma dhanë votën për katër mandate me radhë që t'i përfaqësoj, besoj që nuk do t'i zhgënjëjmë.

Ajo që dëshiroj të them këtu, nuk kisha dashur që të na ndjek hija, inercioni i bllokadës gjashtëmujore, të nderuar deputetë, ajo është e stërtepruar dhe ne tani e kemi në duar tona që t'i themi stop bllokimit të institucioneve. Sot jemi këtu që ta bëjmë funksional Kuvendin e Kosovës me votën e juaj, në mënyrë që t'i zgjedhim organet e Kuvendit, siç janë komisionet parlamentare.

Nuk është mirë që të vazhdojnë ato inate dhe të bllokohet institucioni, sepse e dimë që secili grup parlamentar, ndoshta edhe deputetët individualisht kanë pakënaqësi, mirëpo kjo të ndodhë ne... të bëjmë edhe kompromise edhe mirëkuptim ndërmjet vete.

Kur jemi te shpërndarja e komisioneve dhe udhëheqja e komisioneve, ajo është e rregulluar me Rregulloren e punës së Kuvendit, neni 65, paragrafi 5 i Rregullores së punës së Kuvendit thotë se kryetarët e komisioneve propozohen nga grupet parlamentare dhe shpërndahen në bazë së fuqisë së votës, kështu përafërsisht.

Kjo nuk është e shpërndarë në këtë mënyrë, le ta dinë edhe qytetarët e Kosovës, që na ndjekin, po edhe ju të nderuar deputetë, sepse grupi më i madh parlamentar, që është Partia Demokratike e Kosovës në Parlamentin e Kosovës në këtë rast është diskriminuar me formulën, me të cilën është zgjedhur udhëheqja e komisioneve parlamentare.

Tjetër, Rregullorja e punës e Kuvendit e parasheh që secili deputet është i obliguar, po e përsëris, i obliguar, të jetë pjesë së paku e një komisioni parlamentar, ndërsa, ne kemi deputetë të cilët nuk janë fare të përfshirë nëpër komisione parlamentare, falë asaj formulës së famshme diskriminuese. Në këtë rast, më lejoni ta përmend, se Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës i ka katër deputetë, të cilët nuk kanë mundësi të marrin pjesë nëpër komisione parlamentare.

Kjo është anti-Rregullores, antiligjore dhe nuk është në favor të përfshirjes, siç e përmendi edhe deputetja Alma Lama. Sigurisht se edhe në Grupin Parlamentar të LDK-së ka deputetë të papërfshirë nëpër komisione dhe kjo nuk është e drejtë. Madje, nuk është e drejtë të përfshihen disa grupe parlamentare me numër njëshifror apo edhe më shumë diçka, të jenë pjesë e të gjitha komisioneve, duke qenë të përfshirë në dy apo tri komisione, e më shumë, dhe të jenë me të drejtë vote.

Në qoftë se, dikush mendon se Kuvendi duhet ta shtojë transparencën ndaj Qeverisë, nuk është arsyetimi që të shtohen shumë komisione, në mënyrë që të ushtrohet transparenca,

transparenca ushtrohet edhe në mënyra të tjera. Deputetët kanë të drejtë, që transparencën dhe kontrollin ta ushtrojnë përmes interpelancave, nëpërmjet formimit të grupeve punuese, që kanë të drejtë të monitorojnë ligje të caktuara dhe ministri të caktuara. Prandaj, edhe unë mendoj që Rregullorja nuk është e favorshme, ka zbrazësi juridike dhe zbrazësi përmbajtjesore, por sot kërkoj që t'i votojmë këto komisione, të fillojë Kuvendi me punën e tij, pastaj kemi mundësi ta ndryshojmë edhe Rregulloren e punës së Kuvendit.

Një gjë që më duhet ta përmend këtu, që Rregullores i mungon dhe që duhet ta ketë edhe Rregullorja të përfshijë edhe kriterin gjinor, sepse siç po shihet shteti i brishtë me moshë një shifrore, demokracia e brishtë, kultura e brishtë dhe respektimi reciprok i brishtë e bëjnë që ne gjithkund të bëjmë kriterë ligjore që “vullnetarisht” ta respektojmë edhe gjininë edhe vlerat tjera që shtetet tjera i kanë rregulluar qysh më herët. Dëshiroj që ta përshëndes edhe ministren e vetme në Kabinetin qeveritar, besoj që nuk duhet ta ndiejë veten të vetmuar se do të na e ketë mbështetje neve. Faleminderit!

KRYETARI: Pra, e lus ta marrë fjalën deputetin Shpejtim Bulliqi, nga Lidhja Demokratike e Kosovës.

SHPEJTIM BULLIQI: I respektuar kryetar i Kuvendit,
I respektuar Kabinet qeveritar,
Të respektuar kolegë deputetë,
Të respektuar qytetarë të Kosovës,
Për mendimin tim që diskutimi rreth asaj që të jenë 16 komisione, 15 apo 14 komisione nuk çon shumë peshë në këtë fazë, sepse mendoj që ne në qoftë se kemi arritur që t'i qesim njerëzit vërtet të përafërt me fushat, me profilet e tyre, besoj që ne ia kemi arritur qëllimin që ne po e dimë të gjithë se qëllimi kryesor i këtyre komisioneve është për ta mbikëqyrë Kabinetin qeveritar.

Prandaj, në bazë të këtyre çka po i shohim, po shohim se edhe në këtë segment kemi një sërë çalimesh për arsye po shohim që njerëzit jo vetëm që janë në krye të komisioneve të cilët shumë pak janë kompetentë për fushat në të cilat janë vu, ose eventualisht janë përfaqësuar vetëm formalisht nëpër këto komisione.

Prandaj më e udhës do të ishte që realisht ne t'i kishim njerëzit e qëlluar nëpër këto komisione, sepse kontributi i tyre me siguri do të jetë më i madh. Faleminderit!

KRYETARI: Zoti Daut Haradinaj, edhe një herë e ka fjalën.

DAUT HARADINAJ: Shefi i Grupit Parlamentar tha para disa ditësh gjithmonë PDK-së po i bie për t'u sakrifikuar. Dhe, sinjerisht më vjen keq, domethënë që po sakrifikoni kaq shumë. Kryetar, na bëni kartelat të flasim prej vendit, të mos iu marrim kohën.

Deputetja që foli më herët duhet ta di që deputetët e Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të shumtë janë në numër që kanë nga dy komisione.

A jeni për ngutë? Ish-ministri i Mbrojtjes, Agim Çeku, e ke ndërruar Komisionin. Shumë mirë, u hoqe prej komuniteteve! As në Mbrojtje s'je! Më fal!

KRYETARI: Faleminderit! Faleminderit për diskutime. Kërkoj falje që në qoftë se kam bërë gabim me vetëdije të plotë dhe qoftë nga dy diskutues për arsye se tashmë e njoh Rregulloren, por si do që të jetë po mundohemi të kemi mirëkuptim, të krijojmë ambient kolegjal, i cili i ndihmon punës së këtij Parlamenti.

Nëse pajtohemi, kishim proceduar me votim për miratimin e propozim-vendimit për formimin e 14 komisioneve parlamentare.

Në sallë janë të pranishëm 111 deputetë.

I kisha lutur deputetët që me ngritje dore të deklarohen.

Kush është për?

Kush është kundër votimit të 14 komisioneve parlamentare?

Kush abstenon?

Kush abstenon, edhe një herë, se unë e pash që pati abstenim, por po e shoh se administrata s'e ka regjistruar, është një abstenim atje lart.

Konstatoj se me 81 vota për, 28 vota kundër dhe 1 votë abstenim, Kuvendi vendosi për formimin e 14 komisioneve parlamentare, emërtimin dhe përbërjen e tyre.

Me këtë i mbyll punimet e seancës plenare, mirupafshim në seancën tjetër.

I kisha lutur shefat e grupeve parlamentare që ta mbajmë një takim tani tek unë, pra në Kabinet të kryetarit të Kuvendit. Faleminderit!

*E përgatiti:
Njësia për Transkriptim dhe Lekturë*